



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:043207
Datë: 13.02.2025
Numri i dokumentit: 06845064

CA.nr.5964/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Besnik Feka dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.B. nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat B.A., nga P., rr.”H.T.” nr..., kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar V.I.Xh., me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe kompenzimin e ushqimit gjatë ditëve të punës - shujtave, duke vendosur sipas ankesës të të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.684/2023, të datës 15.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.684/2023, i datës 15.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.684/2023, të datës 15.12.2023, ka vendosur si vijon: *“I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.B. nga P., DETYROHET e paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia kompensoj: - në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit: për periudhën kohore Mars - Dhjetor 2021 në shumën prej 143.14 euro; për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro; dhe në emër të shujtave ditore për 288 ditë pune, (për periudhën prej datës 06.03.2021 deri më datën 21.11.2022) t’ia paguaj shumën prej 576.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,241.62 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.02.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto*

në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit. II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të i`a paguaj shumën prej 124.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura DKA Prizren, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e të paditurës, të prishet aktgjykimi i atakuar me ankesë dhe të hedhet poshtë padia, apo të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe të prishet aktgjykimi i atakuar ashtu që çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësja.

Gjykata e Apelit të Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja B.B. nga Prizreni në gjykatën e shkallës së parë me datë 16.02.2023, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës - shujtave.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, si dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në bazë të nenit 152 të LPK-së, (pa shqyrtim kryesor të çështjes) ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.684/2023 të datës 15.12.2023, me të cilin ka vendosur që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nuk është kontestuese fakti fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës në SH.F.M.U. “Ekrem Rexha” në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit. Nga vërtetimi i datës 08.11.2023, i lëshuar nga drejtori i shkollës të SH.F.M.U. “Ekrem Rexha” në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Behare Bytyqi, nga Prizreni, është në marrëdhënie pune-edukatore pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021 dhe 2022 (për periudhën prej datës 06.03.2021 deri më datën 21.11.2022), ka punuar gjithsej 288 ditë pune. Gjykata ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në bazë të nenit 35 par.7 dhe 10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, si dhe si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 të datës 09.10.2023. Për kumatën ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, bazuar në Mendimin Juridik për

Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jokontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditëses dhe nuk ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike pasi nuk ka qenë kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës në SH.F.M.U. “Ekrem Rexha” në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit. Nga vërtetimi i datës 08.11.2023, nga drejtori i shkollës të SH.F.M.U. “Ekrem Rexha” në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Behare Bytyqi, nga Prizreni, është në marrëdhënie pune-edukatore pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021 dhe 2022 (për periudhën prej datës 06.03.2021 deri më datën 21.11.2022), ka punuar gjithsej 288 ditë pune. Po ashtu gjykata u bazua në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas *Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës*, ku ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%, ashtu që për periudhën Mars - Dhjetor 2021, paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 \times 3.4\% = 14.31$) dhe për periudhën Janar 2022 - 21 Nëntor 2022, paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.48 euro [$421 \times 11.6\% = 48.83$] dhe për periudhën 21 Nëntor 2022 - 21 Nëntor 2023, paga bazë e paditëses në vitin 2023 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.48 euro [$421 \times 11.6\% = 48.83$].

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë dhe mbi bazën e inflacionit, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të dates 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*, ndërsa me nenin 35 paragrafi 10, përcaktohet: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*. Sipas Mendimin Juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 të dates 09.10.2023 në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASh, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar

dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pathemeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.5964/2024, datë 10.02.2025

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.